

ABSTRAKT

Ky punim diplome ka për qëllim të shqyrtojë dukurinë e heqjes dorë nga trashëgimia dhe çështjet e ndërlidhura, brenda praktikës në Kosovë. Trashëgimia është një çështje e ndjeshme, ku trashëgimtarët përballen me sfida kur marrin vendime të rëndësishme në lidhje me pasuritë e mbetura pas vdekjes së një të afërmi.

Në këtë studim do të shpjegojmë konceptin e heqjes dorë nga trashëgimia. Analizohen arsyet dhe pasojat e këtij veprimi në kontekstin e Kosovës. Duke përdorur referencat, do të shqyrtojmë legjislacionin në Kosovë që rregullon heqjen dorë nga trashëgimia dhe do të identifikojmë problemet dhe sfidat eventuale.

Një pjesë e konsiderueshme e punës fokusohet në praktikën lidhur me rastet e heqjes dorë nga trashëgimia. Duke analizuar rastet gjyqësore në gjykatat e Kosovës, ku do të vlerësohet qasja e organeve të drejtësisë lidhur me këtë çështje.

Përveç analizimit të praktikave, do të bëhet një hulumtim i heqjes dorë nga trashëgimia si fenomen i shpeshët në shoqëri dhe ndikimin që ka ky fenomen në marrëdhëniet familjare.

Në përfundim, do të paraqitet një vështrim të gjerë mbi sfidat dhe perspektivat sa i përket kësaj procedure. Duke mbështetur konkluzionet e arritura, në raportet e organizatave ndërkombëtare dhe referencat tjera relevante, do të jepën rekomandime për përmirësimin e praktikës gjyqësore dhe rregullimin e heqjes dorë nga trashëgimia në vend.

MENTOR:

PROF. ASOC. DR. BEDRI BAHTIRI

STUDENTE:

RINA QERIMI